



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 6 regjistër (JR)
Datë 07.02.2019

Nr. 25 i vendimit
Datë 14.10.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Luan Daci	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 14.10.2019, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Mia LHE Roessingh Bakels, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 6, datë 07.02.2019, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Artur Selmani, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 82, datë 26.11.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 49, 55, 65 dhe neni 66, pika 1, germa "c" e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; neni 47 dhe neni 51, pika 1, gjerat "a", "b" dhe "c" të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016"), dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, analizoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), me vendimin nr. 82, datë 26.11.2018, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artur Selmani, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë.
2. Komisioni arriti në këtë përfundim pasi administroi tri raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim "ILDKPKI") në bazë të neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim "DSIK") në bazë të neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016 dhe nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim "KLD") në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, kreu hetimin administrativ dhe vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Artur Selmani, bazuar në nenin 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.
3. Trupi gjykues i Komisionit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, zhvilloi seancën dëgjimore publike, mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit dhe arriti në përfundimet vijuese.

3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

i. Për pasurinë "apartment banimi, me sipërfaqe 119 m²", subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm të kundërtën e faktit të konstatuar se ka mospërputhje në deklarin e sipërfaqes së apartamentit; arriti të shpjegojë bindshëm se shuma prej 4.000.000 lekësh i ishte kaluar shitësve dhe pse pa një dokument ligjor provues; kishte burime financiare të ligjshme për blerjen e këtij aseti me anë të huas.

ii. Për pasurinë "depozitë bankare pranë Raiffeisen Bank, në shumën 2.500.000 lekë dhe gjendje cash në shumën prej 950.000 lekësh", subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për burimin e krijimit të depozitës dhe gjendjes cash.

iii. Për të ardhurat e fituara në lotari sportive në vlerën 10.000 USD, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të vërtetuar këto të ardhura, fituar gjatë viteve 2006-2008, të ardhura që kishin shërbyer si burim për krijimin e depozitës dhe gjendjes cash (sipas pikës "ii" më sipër), deklaruar në deklaratën vetting të vitit 2017.

iv. Për shumat e dhuruara nga motra e subjektit, znj. T. S., në vlerën 16.950 euro dhe nëna e subjektit, znj. D. S., në vlerat 600.000 lekë dhe 11.880 euro, subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga dhuratat e bëra nga motra e subjektit, znj. T. S., dhe për pasojë ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare me dokumentacion justifikues për këto dhurata, të bëra gjatë viteve 2009-2013, në vlerën 13.950 euro.

v. Për "transfertat e kryera nga subjekti apo personat e lidhur me të, nëpërmjet Unionit Financiar të Tiranës subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të provuar se motra e tij, znj. T. S., ka pasur të ardhura nga burime të ligjshme për të bërë dhuratën në shumën prej 950,5 eurosh.

Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm dhe provoi edhe që personat me të njëjtin emër dhe mbiemër me të dhe bashkëshorten e tij kishin kryer transaksione me Unionin Financiar, "AK Invest", por që nuk ishin të njëjtët persona me subjektin dhe bashkëshorten e tij, vërtetuar kjo me kartën e identitetit dhe letrën e dërguar nga "AK Invest".

vi. Për "të ardhurat në shumën 954.167 lekë nga angazhimi në përgatitjen e revistës "{***}", projekt i Qendrës {***}", subjekti i rivlerësimit arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor këto të ardhura.

vii. Për analizën financiare të kryer për vitet 2003-2016, duke marrë në konsideratë shpenzimet jetike të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në tetor 2018, Komisioni ka dalë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të të ardhurave, shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor në shumën prej - 3.533.901 lekësh, për periudhën 2003-2016.

3.2. Për kriterin e vlerësimit të figurës, raporti i dërguar nga DSJK-ja, i cili konstaton papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, nuk merret në konsideratë nga Komisioni, si i pabazuar në prova dhe fakte.

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

i. Subjekti i rivlerësimit, referuar dhe urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm, por dhe komenteve në media të ndryshme të shkruara apo audiovizive të kohës, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

ii. Sjelljet e subjektit të rivlerësimit, të lidhura me luajtjen në lotaritë sportive, kanë cenuar figurën dhe integritetin e tij, si dhe kanë ulur shkallën e besueshmërisë nga publiku te sistemi i drejtësisë.

3.4. Për vlerësimin tërësor të çështjes, subjekti i rivlerësimit, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tij në lidhje me vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e përgjithshëm të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

4. Në përfundim, Komisioni vendosi që subjektin të rivlerësimit Artur Selmani, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet D, Dh, Ç, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

I. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 82, datë 26.11.2018 të Komisionit, ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit, i cili kërkon:

5.1. Kalimin e vendimit nr. 82, datë 26.11.2018, për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, duke administruar me cilësinë e provës:

i. aktet e dosjes hetimore të Komisionit, përfshirë shpjegimet e subjektit, si dhe dokumentet e depozituara nga subjekti pranë Komisionit me cilësinë e provës;

ii. dokumentet e depozituara nga subjekti së bashku me ankimin, që janë:

- deklaratë e znj. D. S., nëna e subjektit;
- dokumente të cilësuar "CUD"¹ për të ardhurat e bashkëshortit të motrës, z. A. A., për vitet

¹ CUD – akronim për Certificato Unico Dipendente, format standard i lëshuar nga INPS (Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore të shtetit italian) ku pasqyrohen të ardhurat e përfituara nga znj. T. S., për vitin 2014, dhe nga bashkëshorti i saj, z. A. A., për vitet 2009-2011, 2013-2014.

2009, 2010, 2011, 2013 dhe 2014.

5.2. Prishjen e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Artur Selmani.

II/1. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

6. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka përdorur standarde të ndryshme arsytimi ligjor për të njëjtat fakte apo situata juridike. Në vendim, Komisioni nuk ka përdorur të njëjtat kriterë provuese rreth deklarimeve të bëra nga subjekti, pasi në disa raste, besueshmërinë e tyre e mbështet në *prova apo indicie të tjera*, pa e kushtëzuar vërtetësinë e tyre me mungesën e një dokumenti justifikues ligjor, ndërsa në raste të tjera, si të deklarimeve të subjektit për të ardhurat, i konsideron ato si të paprovuara, bazuar në kriterin objektiv, mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor, pa pranuar të vlerësojë praninë e provave apo indicieve të tjera që e konfirmojnë besueshmërinë e këtyre deklarimeve, konkretisht:
 - 6.1. Ndërsa Komisioni pranon vërtetësinë e deklarimeve të subjektit rreth ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë "apartament banimi me sipërfaqe 119 m²" bazuar në indicie, lidhur me të ardhurat nga lotaritë sportive, nga dhurimet e motrës, si dhe nga shitja e apartamentit të familjes në vitin 1996, Komisioni përdor si kriter provueshmërie vetëm kriterin objektiv, atë të mungesës së dokumentacionit ligjor justifikues, pa marrë parasysh deklaratimet e subjektit.
 - 6.2. Komisioni, në kundërshtim me provat dhe indiciet në dosje, nuk ka konsideruar si të ardhur nga një burim i ligjshëm të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 1996, në vlerën 870.000 lekë, si dhe të ardhurat nga puna të subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës 1996 - 2002, ndërkohë që në paragrafin 5.15, pika "ii" e vendimit, Komisioni i konsideron si të ardhura të ligjshme të ardhurat e siguruar nga pensioni i pleqërisë së nënës, duke pranuar deklaratimet e subjektit si të mjaftueshme për të vërtetuar burimin e ligjshëm të kësaj të ardhure, nisur nga indicia *jetesë e përbashkët me nënën, në përbërje të së njëjtës familje*.
7. Komisioni, në kundërshtim me provat dhe indiciet, nuk ka konsideruar si të ardhur nga një burim i ligjshëm të ardhurat nga lotaritë sportive, edhe pse për periudhën kur janë deklaruar këto të ardhura nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor mbi subjektin për t'u pajisur me dokumente justifikuese ligjore.
8. Komisioni, në kundërshtim me provat dhe indiciet, nuk ka konsideruar si të ardhur nga një burim i ligjshëm të ardhurat nga dhuratat e motrës së subjektit, por në kundërshtim me ligjin i ka kaluar subjektit barrën e provës, pa realizuar barrën e vet të provës. Lidhur me këtë pretendim, subjekti ka paraqitur së bashku me ankimin prova të reja, të cilat ka kërkuar të shqyrtohen nga Kolegji.
9. Sipas subjektit të rivlerësimit, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit dhe mosshqyrtimit të të gjitha provave, Komisioni ka bërë përllogaritje të gabuar të pasurisë së subjektit, duke konstatuar diferencë negative joreale, në vlerën rreth 3.500.000 lekë, pasi nuk ka përfshirë në llogaritjet e veta të ardhurat nga lotaritë sportive, dhurimet nga motra, mbartjet e balancave pozitive mes të ardhurave dhe shpenzimeve që rezultojnë në fund të çdo viti për vitin në vijim, të ardhurat që rezultojnë nga shitja e apartamentit në vitin 1996, si dhe të ardhurat nga puna e subjektit për vitet 1987-2002.

10. Sipas subjektit të rivlerësimit, edhe nëse përlogaritjet e Komisionit, pa përfshirë të ardhurat nga lojërat e fatit dhe dhuratat nga motra, do të konsideroheshin të sakta, pas mbledhjes së të gjitha diferencave pozitive dhe negative të rezultuara për çdo vit të periudhës së analizuar, rezultati financiar përfundimtar i pasurisë rezulton pozitiv, në vlerën 404.983 lekë.
11. Nuk rezulton që pasuria aktuale e subjektit të rivlerësimit të ketë arritur vlera të patolerueshme në ligj, në kuptim të raportit kushtetues 2 me 1, mes të ardhurave me burim të ligjshëm dhe të ardhurave me burim të pajustificuar me dokumente ligjore.

II/2. Shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës

12. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti deklaron se nuk ka arsye për të kundërshtuar vendimin e Komisionit në parim, por megjithatë nisur nga fakti që Komisioni u tërhoq nga konkluzioni i arritur prej tij në rezultatet e hetimit administrativ për papërshtatshmërinë e figurës së subjektit, konfirmon indirekt se ka qenë i pabazuar në një shqyrtim serioz provash dhe faktesh, për më tepër që gjatë seancës dëgjimore nuk rezulton të jenë administruar prova apo fakte të reja lidhur me këtë kriter rivlerësimi.

II/3. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

13. Në kryerjen e vlerësimit profesional, Komisioni ka shkelur rregullat procedurale të parashikuara nga ligji, që saktësojnë periudhën e rivlerësimit profesional, pasi vlerësimi profesional bëhet vetëm për 3 (tri) vitet e fundit të ushtrimit të detyrës, ndërkohë që Komisioni ka tejkalluar këtë afat duke zgjatur periudhën e rivlerësimit pa marrë një vendim për këtë, sipas pikës 57 të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese.
14. Komisioni ka shkelur parimin e proporcionalitetit në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi *së pari* hetimi nuk ka qenë i balancuar, duke qenë se nga ligjvënësi nuk është konceptuar si një aktivitet faktmbledhës rreth elementeve negative profesionale, por si aktivitet i balancuar që evidenton si elementet profesionale negative, ashtu edhe ato pozitive, *së dyti*, konkluzioni përfundimtar rreth vlerësimit profesional duhet të jetë rrjedhojë e një vlerësimi të ponderuar rreth gjetjeve negative dhe pozitive, pra në varësi të peshës specifike që zë secili vlerësim. Lidhur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendon se hetimi rreth vlerësimit profesional është kryer në mënyrë të njëanshme dhe konkluzionet në vendim janë nxjerrë nga Komisioni pa kryer asnjë ponderim të elementeve pozitive me ato negative. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka anashkalluar shqyrtimin e rrethanave të tjera që ndihmojnë në vlerësimin profesional të tij në mënyrë proporcionale.
15. Vlerësimi profesional i subjektit është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit nga Komisioni, lidhur me cilësinë ligjore të pezullimit të subjektit të rivlerësimit nga detyra, pasi ky pezullim ka qenë i llojit detyrues dhe jo i dhënë si një masë disiplinore, duke qenë se ndaj subjektit nuk është zhvilluar për asnjë moment një procedurë disiplinore.

16. Komisioni ka gabuar në zbatimin e ligjit, kur vlerësimin profesional të subjektit e bazon te qëndrimet dhe opinionin ligjor i shfaqur nga subjekti i rivlerësimit para Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për çështjen penale me të pandehur A. Ll., A. B. dhe B. A., pasi kjo përbën kapërcim të kompetencave që i ka njohur ligji. Gjithashtu, Komisioni ka vepruar në kundërshtim me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese, pika 54, pasi nuk ka konstatuar që opinionin i subjektit para Kolegjit Penal ka pasur gabime thelbësore dhe serioze dhe nuk i ka rezultuar që gjatë veprimtarisë së subjektit të jetë shfaqur një seri e qartë dhe e vazhdueshme gjykimesh të gabuara.
17. Komisioni ka bërë një vlerësim të gabuar të provave që flasin rreth vërtetësisë së deklarimeve të subjektit për përfaqësimin para Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për një çështje penale, pasi këto deklarime konfirmohen me deklaratimet e ndihmëses ligjore të subjektit të rivlerësimit, znj. K. M., ndërkohë që deklaratimet e ish-drejtoreshës A. M. nuk konfirmohen me asnjë provë tjetër.
18. Komisioni ka shkelur parimin e ligjshmërisë lidhur me konkluzionin se pjesëmarrja e subjektit në lotaritë sportive, si "ves i keq", ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke e mbështetur këtë konkluzion jo në ndonjë ligj apo kod etik sjelljeje, por te prania e opinionëve negative në media, pra në një vlerësim krejt subjektiv, të paverifikueshëm me prova dhe, si të tillë, krejt arbitrar.
19. Komisioni ka shkelur parimin e proporcionalitetit, pasi, edhe pas konstatimit të shkeljes si në kundërshtim me ligjin apo kodin etik, ai duhet të shqyrtonte faktet dhe rrethanat që tregojnë për rëndësinë që ka ajo shkelje nisur nga rrethana të tilla, si: përsëritja, koha kur ka ndodhur, qëndrimi i magjistratit rreth saj, pasojat që ka shkaktuar etj., si dhe ka anashkaluar vlerësimin pozitiv profesional për 8 (tetë) dokumente ligjore.

II/4. Shkaqet e ankimit për vlerësimin tërësor të çështjes

20. Komisioni ka bërë një vlerësim tërësor në kundërshtim me kuptimin që i jep ligji vlerësimit tërësor, pasi, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, kur Komisioni vendos ta mbështesë vendimin në vlerësimin tërësor, ai duhet të parashtojë rezultatet e arritura nga hetimi administrativ në të tria kriteret së bashku dhe jo vetëm në atë kriter që Komisioni ka konkluduar me vlerësime negative. Më pas, Komisioni duhet të parashtojë gjetjet e veta rreth secilit kriter më vete, si ato pozitive ashtu edhe negative. Në fund, Komisioni duhet të parashtojë në mënyrë të arsyetuar se cilat gjetje, ato negative apo pozitive, kanë më shumë peshë në vlerësimin tërësor të të tria kriterëve.
21. Në kapitullin VIII të vendimit të Komisionit që trajton *vlerësimin tërësor të çështjes*, mungon arsyetimi i vendimit, pasi Komisioni ka bërë vetëm një përsëritje të përmbledhur të konkluzioneve të veta për secilin kriter, duke shfaqur në vendim një kuptim të gabuar mbi procedurën e rivlerësimit tërësor, ndërkohë që duhet të paraqiste gjetjet pozitive dhe negative për secilin nga tri kriteret e rivlerësimit dhe më pas të analizonte rëndësinë e secilës gjetje, duke i dhënë secilës prej tyre peshën e vet specifike në konkluzionet e Komisionit.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për kriterin e pasurisë

Subjekti i rivlerësimit Artur Selmani, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar më datë 30.01.2017 “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, vetting”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar: *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë, subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Së bashku me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur deklaratën e znj. D. S., nëna e subjektit, dhe fotokopje, jo në formën e kërkuar nga ligji, të dokumenteve të cilësuar “CUD”, për të ardhurat e bashkëshortit të motrës së subjektit, z. A. A., për vitet 2009, 2010, 2011, 2013 dhe 2014. Trupi gjykues me vendim të ndërmjetëm refuzoi marrjen e provave të reja më sipër, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

III/1. Pasuritë “depozitë bankare pranë Bankës Raiffeisen, në shumën 2.500.000 lekë” dhe “gjendja *cash* në shumën 950.000 lekë”.

22. Për këtë pasuri, Komisioni në vendim ka arritur në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit:
 - i. ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të vërtetuar të ardhurat nga lotaritë sportive në shumën prej 10.000 USD fituar gjatë viteve 2006-2008, të cilat kishin shërbyer si burim për krijimin e depozitës dhe gjendjes *cash*, të deklaruar në deklaratën vetting të vitit 2017;*
 - ii. nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga dhuratat e bëra nga e motra, znj. T. S., dhe për pasojë ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare me dokumentacion justifikues për këto dhurata të bëra gjatë viteve 2009-2013, në vlerën 13.950 euro.*
23. Lidhur me pasuritë likuiditete si më sipër, trupi gjykues konstaton se janë deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2016, me burim krijimi “kursimet në vite prej burimeve të të ardhurave nga rroga e përfituar në detyrat shtetërore dhe shpërblimet nga burimet e deklaruara periodikisht çdo vit [...]”.
24. Në deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar “depozitë bankare pranë Bankës Raiffeisen”, në shumën 2,5 milionë lekë [...], që përfaqëson “pjesë nga kursimet në vite prej burimeve të të ardhurave nga rroga në detyrat shtetërore të kryera dhe shpërblimeve të përfituara nga burimet e deklaruara në këtë deklaratë”, si dhe “gjendje në *cash* në vlerën 950.000 lekë”, të cilat përfaqësojnë “pjesë nga kursimet në vite, prej burimeve të të ardhurave të deklaruara në këtë deklaratë [...]”, ku nënkupton deklaratën e pasurisë *vetting* 2017, ndërkohë që nga analizimi i kësaj deklarate nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit t’i ketë deklaruar në seksionin “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej

tyre" të ardhurat nga *lotari sportive* (2006-2008) apo nga *dhuratat e nënës e motrës në cash* (2008-2015).

Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se pasuritë likuiditete më sipër janë krijuar me burimet e deklaruara periodikisht çdo vit, ku përfshin të ardhurat e përfituara nga lotaritë sportive në vitet 2006-2008, si dhe dhuratat në *cash* nga nëna dhe e motra të deklaruara në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të viteve 2008-2015, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e pretenduara të përfituara nga lotaritë sportive në vitet 2006-2008, në vlerën 10.000 USD, të cilat sipas subjektit të rivlerësimit kanë shërbyer për krijimin e depozitës 2.500.000 lekë dhe gjendjes *cash* në shumën 950.000 lekë.

25. Lidhur me pretendimin në ankim të subjektit të rivlerësimit se nuk ka qenë detyrim ligjor të ruante dokumente ligjore për të justifikuar të ardhurat nga lotaritë sportive, trupi gjykues vlerëson se neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 detyrojnë subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur, që të justifikojnë me dokumentacion vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Në bazë të udhëzimit të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, *Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, në pikën nr. 7 të të cilit parashikohet: “Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojnë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre”, ndërsa në pikën nr. 27 të po këtij udhëzimi specifikohet se: “[...] dokumentacioni justifikues i dorëzuar më parë në ILDKPKI nuk e shkarkon subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nga përgjegjësia dhe detyrimi për dorëzimin e të gjithë dokumentacionit justifikues në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, *Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”. Rezulton se të ardhurat e pretenduara të përfituara nga lotaritë sportive në vitet 2006-2008 nuk janë të ligjshme, pasi trupi gjykues në bazë të arsytimit të mësipërm vlerëson se në këtë proces, subjektet e rivlerësimit kanë barrën e provës për të provuar me dokumentacion ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurive të tyre, ndaj në kushtet kur nuk u provua me dokumentacion justifikues, në bazë të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ligjshmëria e burimit për të ardhurat e pretenduara të përfituara nga lotaritë sportive, si dhe nuk u provua as pamundësia objektive për të disponuar dokumentacionin që justifikon ligjshmërinë e burimit të këtyre të ardhurave, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, të ardhurat nga lotaritë sportive nuk merren në konsideratë si të ardhura të realizuara nga burime të ligjshme.

25.1 Lidhur me detyrimet e bëra subjektit të rivlerësimit nga motra T. S. dhe nëna D. S., trupi gjykues vlerëson sa vijon.

Referuar certifikatës familjare të dërguar me shkresën nr. {***} prot., datë 16.02.2018, nga Njësia Administrative nr. {***} e Bashkisë Tiranë, e administruar në dosjen e gjykimit, në përbërjen familjare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 20.02.2001 - 10.10.2009, kanë qenë motra e subjektit të rivlerësimit, znj. T. S. dhe nëna e tij, znj. D. S..

Kjo përbërje familjare është e njëjtë edhe sipas certifikatës familjare të lëshuar më datë 21.07.2014. Ndërsa sipas certifikatës familjare të lëshuar më datë 28.01.2017, rezulton që familja e subjektit të rivlerësimit përbëhet nga bashkëshortja e tij dhe dy fëmijët, duke mos qenë më pjesë e gjendjes familjare nëna dhe motra e subjektit të rivlerësimit.

Në dosjen e gjykimit gjendet një certifikatë martesore n. {***} art. {***} e {***} D.P.R. 3.12.2000, n. {***}² e znj. T. S., motrës së subjektit të rivlerësimit, me A. A., në gjuhën italiane, e papërkthyer, e panoterizuar dhe pa vulë *apostille*. Në këtë rast, Komisioni këtë certifikatë duhet ta kishte administruar si provë nëse ajo paraqitej dhe përmbushte kërkesat e nenit 266 të Kodit të Procedurës Civile.

Në certifikatën martesore të cituar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që në këtë akt për lidhje martese, motra e subjektit të rivlerësimit, znj. T. S., dhe z. A. A. të kenë zgjedhur regjimin martesor me pasuri të ndara, ndërkohë që në deklaratën e dhënë, z. A. A. ka pranuar që dhurimet janë kryer nga bashkëshortja T. S., me pëlqimin e tij.

Trupi gjykues konstaton se edhe kjo deklaratë, e dërguar me *e-mail* subjektit të rivlerësimit, është fotokopje, e përkthyer në shqip, me vërtetim noterial, e nënshkruar nga përkthyesi, por jo e njësuar nga shteti italian. Pra, deklarata e bërë nga z. A. A. nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 266 të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk mund të konkludohet që të jetë një dokument autentik.

Ndërkohë, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, konstaton mospërputhje midis deklarimeve të motrës së subjektit dhe vetë subjektit të rivlerësimit, lidhur me qëllimin e përdorimit të këtyre dhurimeve, pasi, ndërsa motra e subjektit deklaron në deklaratën e datës 07.05.2018 se i ka dhënë të vëllait këto dhurata për të mbuluar shpenzimet që nëna do të bënte gjatë qëndrimit pranë familjes së tyre në Tiranë³, vetë subjekti deklaron se me paratë e dhuruara ka krijuar depozitën në shumën 2,5 milionë lekë.

Në dosjen e gjykimit gjendet dokumenti "Quadro RN IRPEF" në gjuhën italiane, i papërkthyer, i panoterizuar, pa vulë *apostille*, sipas të cilit rezulton që motra e subjektit të rivlerësimit, znj. T. S., të ketë realizuar për vitin 2014 të ardhura në vlerën 11.945 euro. Komisioni e ka njohur si dokument ligjor për justifikimin e dhurimit në shumën 3.000 euro, bërë subjektit të rivlerësimit në vitin 2014, nga motra e tij.

Bazuar në gjithë sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se motra e subjektit të rivlerësimit, znj. T. S., është person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, pasi del qartë se ajo ka pasur marrëdhënie interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror në një

² Estratto per Riassunto Dell'atto di Matrimonio, Comune di Bergamo.

³ Referuar deklaratës së bashkëshortit të motrës së subjektit të rivlerësimit dhe deklaratës së nënës së tij, znj. D. S. ka jetuar me të bijën në Itali prej vitit 2006 e në vazhdim.

nga format e përcaktuara në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, siç janë edhe dhurimet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, përkatësisht në shumën 16.950 euro, nga viti 2009 deri në vitin 2014.

Bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon: "Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.", në kuadër të dhurimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave privatë/periodikë vjetorë, personi tjetër i lidhur ka detyrimin të justifikojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave për dhurimet e bëra subjektit të rivlerësimit, në shumat përkatëse.

Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e gjykimit, motra e subjektit të rivlerësimit, znj. T. S., nuk provoi me dokumentacion ligjor se kishte të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme, duke filluar nga viti 2009 deri në vitin 2013, për t'i bërë dhurata subjektit të rivlerësimit.

25.2 Lidhur me të ardhurat nga dhurimet e bëra nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. D. S., në vlerën totale 600.000 lekë dhe 11.880 euro, trupi gjykues vlerëson sa vijon.

Së pari, nëna e subjektit të rivlerësimit është person i lidhur në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, për periudhën në të cilën ajo ka qenë pjesë përbërëse e gjendjes familjare të subjektit, si dhe person tjetër i lidhur sipas nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, pasi ajo ka pasur marrëdhënie interesi në formën e dhurimit me subjektin e rivlerësimit për dhurimet prej vitit 2008 deri në vitin 2015, sipas deklarimeve të bëra në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të viteve 2008-2015.

Së dyti, trupi gjykues vëren në paragrafin 2.44 të vendimit të Komisionit, ku shprehimisht shkruhet: "Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me dhurimin në shumën 11.880 euro dhe 600.000 lekë bërë nga nëna e tij, znj. D. S., e cila i kishte përfituar nga pensioni në Itali dhe në Shqipëri, solli dokumentacion justifikues duke vërtetuar shumën mujore që ajo merrte nga pensioni" se Komisioni pranon që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion justifikues për të provuar shumën mujore të përfituar prej nënës së tij nga pensioni i lidhur në Itali.

Në paragrafin 5.15, pika "ii" e vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se në analizën financiare të kryer, janë marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e nënës të përfituara nga pensioni i lidhur në Shqipëri, pasi shprehimisht është shkruar: "Duke marrë në konsideratë në analizën financiare të viteve 2003-2016: [...] të ardhurat e siguruara nga pensioni i pleqërisë në Shqipëri të përfituara nga nëna e subjektit të rivlerësimit D. S., sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, për periudhën 1996-2016 [...]".

Gjithashtu, në seksionin VIII, "Vlerësimi tërësor i çështjes", paragrafi "a"/2/"i" i vendimit, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit "[...] nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga dhuratat e bëra nga motra e subjektit, znj. T. S., dhe nëna e subjektit, znj. D. S.".

Për sa më sipër, duke qenë se Komisioni nuk ka qenë i qartë në vendimmarrjen e tij sa u takon dhurimeve të bëra nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. D. S., trupi gjykues i Kolegjit e gjen me vend të arsyetojë sa vijon.

Lidhur me të ardhurat nga pensioni i nënës së subjektit të rivlerësimit të përfituara në Itali, në dokumentacionin e administruar në dosjen e gjykimit, konstatohet se për këto të ardhura janë vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit disa akte në gjuhën italiane, të papërkthyer, të panoterizuara dhe pa vullë *apostille*. Në këtë kontekst, duke qenë se nga subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit dokumentacion në përputhje me kërkesat e nenit 266 të Kodit të Procedurës Civile, për të provuar mundësinë financiare të nënës së tij për të kryer dhurimet përkatëse me të ardhura nga burime të ligjshme, trupi gjykues arrin në përfundimin që të ardhurat si më sipër të nënës së subjektit të mos merren në konsideratë si burim i ligjshëm për të justifikuar dhurimet ndër vite.

26. Lidhur me të ardhurat nga shitja e banesës në vitin 1996, trupi gjykues vlerëson sa vijon.

Nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. D. S., ka shitur sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.05.1996, në vlerën 870.000 lekë, ish-banesën shtetërore të përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} me Komunale Banesa Tiranë. Këto të ardhura, së bashku me të ardhurat nga kursimet nga pagat, nga subjekti i rivlerësimit pretendohet se kanë krijuar depozitën në vlerën 1.172.272 lekë (e dokumentuar kjo depozitë për herë të parë më datë 08.04.2005, si gjendje e mëparshme), depozitë e padeklaruar ndonjëherë në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë.

27. Në kartelën e pasurisë “apartament, me nr. {***}, zk. {***}, rr. “{***}”, Tiranë”, trupi gjykues konstaton se përpara se të shitej, apartamenti ka qenë në pronësi të znj. D. S., znj. T. S. dhe z. Artur Selmani, kjo edhe në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në nenin 9 të të cilit parashikohet: “Banesat që privatizohen do të regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe anëtarëve të tjerë madhorë të familjes”. Nisur nga fakti që kjo banesë është privatizuar sipas ligjit më sipër, si dhe faktit që subjekti i rivlerësimit dhe motra kanë qenë madhorë në kohën e privatizimit të banesës (ose më saktë që nga koha e hyrjes në fuqi të ligjit, meqenëse kontrata e privatizimit nuk ka datë), trupi gjykues vlerëson se vlera 870.000 lekë, e përfituar nga shitja e saj, u takon të tre anëtarëve të familjes në mënyrë përpjesëtimore me pjesën e tyre takuese, pavarësisht se si shitës në kontratë është shfaqur vetëm nëna e subjektit të rivlerësimit.

28. Duke qenë se në dosjen e gjykimit mungon dokumentacioni i Bankës Raiffeisen (ish-Banka e Kursimeve) përpara datës 08.04.2005, kjo sipas shkresave nr. {***} prot.¹, datë 18.10.2018 dhe nr. {***} prot., datë 13.11.2018, si dhe shkresës kthim përgjigjeje e datës 13.11.2018, sipas së cilës për arsye objektive të njohura, banka nuk disponon dokumentacion elektronik përpara kësaj date, si dhe për shkak të tejkalimit të afateve kohore të ruajtjes së dokumentacionit në arkiv, trupi gjykues konstaton se nuk mund të evidentohet momenti i saktë i krijimit të depozitës në shumën 1.172.272 lekë, si dhe ecurisë së saj. Kjo depozitë e padeklaruar në asnjë deklaratë të interesave privatë/periodikë vjetorë shfaqet si tepriçë llogarie e mëparshme, e mbartur më 08.04.2005. Fakti që depozita si më sipër vjen nga një gjendje e mëparshme, e mbartur, krijon bindjen, sipas shpjegimeve të subjektit, që kjo depozitë është rezultat i të ardhurave nga shitja e banesës në vlerën

870.000 lekë dhe nga të ardhurat e mundshme familjare në vlerën 302.272 lekë.

29. Nga shqyrtimi i deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë 2003-2016, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në asnjërin prej tyre likuiditetet në banka apo ato *cash* të kursyera e "të ruajtura" në llogarinë bankare në emër të nënës së tij, znj. D. S., të cilat mund t'i ketë krijuar për shkak të faktit që subjekti i rivlerësimit ka pasur 1/3 pjesë takuese në të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës në vitin 1996 si analizuar më lart, si dhe nga të ardhurat nga pagat. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar depozitën e mësipërme as kur ajo ka kaluar në llogari dyemërore, në emër të tij dhe të nënës së tij, në datën 28.07.2005, dhe as kur e njëjta depozitë ka kaluar si depozitë dyemërore, në emër të tij dhe të bashkëshortes së tij, në datën 29.08.2006.
30. Nga analizimi i dokumenteve bankare në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se prej depozitës në Bankën Raiffeisen, në shumën 1.172.272 lekë, më datë 08.04.2005, në emër të znj. D. S. është transferuar më datë 28.07.2005, shuma 1.150.000 lekë në llogarinë e përbashkët të znj. D. S. dhe z. Artur Selmani, në të njëjtën bankë, dhe më pas nga kjo llogari, më 25.09.2006, është transferuar shuma prej 1.177.870 lekësh në llogarinë e përbashkët të subjektit të rivlerësimit me personin e lidhur, bashkëshorten e tij.
31. Duke qenë se, sipas certifikatës familjare, si znj. D. S., ashtu edhe znj. T. S. kanë qenë pjesë/anëtarë të familjes deri në datën 10.10.2009, të dyja, si nëna, ashtu edhe motra e subjektit të rivlerësimit konsiderohen *persona të lidhur*, në zbatim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016. Nisur nga fakti që znj. D. S. dhe znj. T. S. *de facto* kanë hequr dorë nga pasuria "depozitë në vlerën 1.172.272 lekë", duke e lënë atë përfundimisht në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, si shpjeguar në paragrafin e mësipërm, është kryer në këtë pikë analiza financiare lidhur me mundësinë e krijimit të kësaj depozite me të ardhura nga burime të ligjshme të të gjithë pjesëtarëve të familjes së bashku, sipas certifikatës së gjendjes familjare, pa marrë në konsideratë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për vitet 2003, 2004 dhe 2005, vite në të cilat subjekti nuk ka deklaruar kursime që të kenë shkuar në drejtim të krijimit të kësaj depozite, pasi nuk e ka deklaruar atë ndonjëherë. Nga analiza e kryer, është arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kishin mundësi ta krijonin këtë depozitë me të ardhura nga burime të ligjshme.
32. Gjithashtu, nga analizimi i dokumenteve bankare të administruara, trupi gjykues vëren se shuma e transferuar në llogari të përbashkët të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, bashkëshortes së tij, së bashku me kursime të tjera të depozituara në të, në vlerën totale prej 1.728.354,65 lekësh, është tërhequr prej tyre nga arka më 13.04.2007. Nisur nga fakti që nuk është deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2007, kursim/gjendje në *cash* e krijuar nga kjo depozitë e tërhequr, trupi gjykues vlerëson se kjo shumë nuk ka shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie të luajtshme apo të paluajtshme në mënyrë specifike, me përjashtim të shpenzimeve të kryera në këtë vit. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit ka luajtur lojëra fati, lotari sportive, në vitin 2007, pasi ka deklaruar të ardhura prej tyre në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit respektiv.
33. Lidhur me shpenzimet dhe kursimet *cash* në banesë, të bëra nga subjekti i rivlerësimit për

periudhën 2003-2016, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë analizën financiare të bërë nga Komisioni, ku shpenzimet për konsum familjar dhe likuiditetet *cash* në banesë për periudhën 01.01.2003 – 31.12.2016, janë konsideruar në përlllogaritjet e kryera në analizë, në vlerat e deklaruar në deklaratën e datës 19.10.2018, dërguar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të Komisionit të datës 15.10.2018⁴, në përputhje me nenet 281 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, si dhe të verifikueshme përmes dokumentacionit të administruar në fashikull.

34. Arsyetimi i mësipërm u bazua në aktet administruara si vijojnë.
- Deklarata *vetting* e vitit 2017, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, më datë 30.01.2017, si dhe dokumentacioni bashkëlidhur.
 - Deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të viteve 2006-2016.
 - Dokumentacioni i administruar nga Prokuroria e Përgjithshme, përgjigjet e të gjitha bankave të nivelit të dytë dhe dokumentacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit të Parave.
 - Kontratë depozite me afat për individë nr. {***}, me vlerën 2.500.000 lekë, me afat 1-vjeçar, pranë Bankës Credins.
 - Dokumentacioni i administruar nga Banka Raiffeisen, me shkresën nr. {***} prot., datë 01.02.2018.
 - Dokumentacioni i administruar nga Banka Credins, me shkresën nr. {***} prot., datë 09.02.2018.
 - Përgjigjet e pyetësorit të datës 15.10.2018 të Komisionit, drejtuar subjektit të rivlerësimit.

III/2. Analiza financiare e kryer për vitet 2003-2016, duke marrë në konsideratë shpenzimet jetike të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në tetor 2018

35. Në lidhje me analizën financiare të kryer për të vlerësuar mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit dhe të personave të lidhur me të, për periudhën 2003-2016, bazuar në përfundimet e arritura nga trupi gjykues pas analizimit ligjor të shkaqeve të ankimit si më sipër, rezultoi që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në vlerën 3,5 milionë lekë. Analiza financiare për të vlerësuar nëse subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të mund të krijojnë pasuritë depozitë në shumën 2,5 milionë lekë dhe kursime *cash* në shumën 950.000 lekë, u krye duke përfshirë në përlllogaritje shumën *cash* prej 3.000 eurosh, të dhuruar nga motra e subjektit të rivlerësimit, znj. T. S., në vitin 2014 dhe pa konsideruar të ardhurat e deklaruar të përfituara nga lotaritë sportive, të ardhurat e deklaruar të përfituara nga dhurimet e motrës për periudhën 2009-2013 dhe dhurimet e nënës për periudhën 2008-2015, të përfituara nga pension i lidhur në Itali, si pretendon subjekti.
36. Lidhur me pretendimin e subjektit për mosmbartjen e balancave pozitive mes të ardhurave dhe shpenzimeve, pra kursimeve të përlllogaritura nga Komisioni, që rezultojnë në fund të çdo viti, në vitin në vijim, trupi gjykues i Kolegjit sqaron se referuar nenit 4, pika d e ligjit nr. 9049, datë

⁴ Sipas përgjigjeve të pyetjeve të pyetësorit të dërguara më datën 15.10.2018, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (fashikulli 4, faqe 469 – 476)

10.04.2003⁵, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”, dhe referuar nenit 7, pika 1 e ligjit më sipër, “në deklarin periodik, jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë [...]”, detyrime ligjore të papërbushura faktikisht nga subjekti i rivlerësimit, pasi ka deklaruar vetëm “kursime nga të ardhurat [...]”, pa specifikuar në asnjë rast nëse i ka *cash* jashtë sektorit bankar apo në sektorin bankar. Në asnjë deklaratë nuk ka deklaruar balanca në llogari bankare, përveç depozitës në shumën 2,5 milionë lekë, të krijuar në vitin 2016, si dhe nuk ka deklaruar shtim apo pakësim të “kursimeve nga të ardhurat”, duke lënë të nënkuptohet që kursimet e pretenduara nuk janë përdorur në vitet pasardhëse, me përjashtim të deklaratës së bërë në vitin 2014, ku deklaroi “pakësim i gjendjes *cash*, në vlerën 600.000 lekë”.

37. Për të kryer analizën financiare për vitet 2003-2016, arsyetimi u bazua në aktet e administruara si vijojnë.
- Deklarata e pasurisë *vetting* 2017, së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur.
 - Deklarata e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, për herë të parë, në vitin 2003.
 - Deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, për vitet 2004-2016.
 - Përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit për pyetëtorin e datës 15.10.2018, ku përcakton shpenzimet e jetesës për secilin vit.
 - Aktekspertimi nga kontabilisti i miratuar, z. E. K., paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në Komision.
38. Për gjithë sa më sipër, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se:
- a) për pasuritë “depozitë bankare pranë Bankës Raiffeisen, në shumën 2.500.000 lekë dhe gjendjen *cash* në shumën 950.000 lekë, të deklaruara në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, subjekti i rivlerësimit:
- i. nuk justifikoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave për dhuratat e bëra nga motra, znj. T. S., për periudhën 2009-2013, dhe nëna, znj. D. S., për të ardhurat që rrjedhin nga pensionet e përfituara në Itali, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këto të ardhura në përputhje me përcaktimet e nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.
 - ii. nuk justifikoi me dokumentacionin e nevojshëm ligjor të ardhurat nga lotaritë sportive, në total në vlerën 10.000 USD për vitet 2006-2008, në përputhje me përcaktimet e nenit 33 pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.
 - iii. ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për periudhën 2003-2016, në vlerën totale 3.533.901 lekë, sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.

V. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

39. Raporti nga grupi i punës pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë

⁵ Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, me ligjin nr. 9475, datë 09.02.2006, me ligjin nr. 9529, datë 11.05.2006, me ligjin nr. 85/2012, datë 18.09.2012, dhe me ligjin nr. 45/2014, datë 24.04.2014.

periudhës objekt rivlerësimi, sipas “shtojcës 4” të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 (pesë) dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konkluduar:

- i. Në lidhje me aftësitë profesionale, rezulton se ato janë shumë mirë.*
- ii. Në lidhje me aftësitë organizative, rezulton se ato janë shumë mirë.*
- iii. Në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, rezulton se ato janë shumë mirë.*
- iv. Në lidhje me aftësitë personale dhe angazhimi profesional, rezulton se ato janë shumë mirë.*
- v. Nga ankesat apo masat disiplinore nga të dhënat arkivore, rezulton se subjekti i rivlerësimit, me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 23.02.2017, është pezulluar nga detyra, pasi ndaj tij ishte regjistruar çështja penale nr. {***}, datë 23.02.2017, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Me urdhrin nr. {***}, datë 03.04.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm, është revokuar urdhri nr. {***}, datë 23.02.2017, dhe subjekti i rivlerësimit është kthyer në detyrë.*

40. Komisioni në vendim, për këtë kriter vlerësimi, ka konkluduar se:

- i. subjekti i rivlerësimit, referuar dhe urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm, por edhe komenteve në media të ndryshme të shkruara apo audiovizive të kohës, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë;*
- ii. sjelljet e subjektit të rivlerësimit ndaj lotarive sportive kanë cenuar figurën dhe integritetin e tij, si dhe kanë ulur shkallën e besueshmërisë nga publiku te sistemi i drejtësisë.*

41. Trupi gjykues i Kolegjit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale vëren sa më poshtë.

Lidhur me çështjen penale në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë më datë 21.02.2017, në media të ndryshme janë publikuar ankesa të familjarëve të viktimave që kanë mbetur të vrarë më datë 07.04.2015, në lagjen “{***}”, Vlorë.

Më datë 23.02.2017, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është regjistruar çështja penale nr. {***}, për veprat penale të “shpërdorimit të detyrës”, “korrupsionit aktiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” dhe “korrupsionit pasiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionareve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga nenet 248, 319, 319/ç të Kodit Penal, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Artur Selmani. Çështja penale është regjistruar mbi bazën e informacionit të publikuar në media të ndryshme.

Në të njëjtën datë, më 23.02.2017, Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr. {***}, ka vendosur pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra deri në përfundim të hetimeve për procedimin penal nr. {***}, datë 23.02.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë, sipas të dhënave arkivore të Vlerësimit Profesional të Prokurorisë së Përgjithshme.

Me urdhrin nr. {***}, të datës 03.04.2017, Prokurori i Përgjithshëm ka revokuar urdhrin e pezullimit nga detyra nr. {***}, datë 23.02.2017.

Në të njëjtën ditë, më datë 03.04.2017, Prokurori i Përgjithshëm me anë të vendimit nr. {***}, ka vendosur që subjekti i rivlerësimit të caktohet përkohësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së

Shkallës së Parë Shkodër për periudhën nga data 04.04.2017 - 04.07.2017, bazuar në nenin 160, pika 4 dhe nenin 59 të ligjit nr. 97/2016.

Në përfundim të hetimeve të kryera, prokurori i çështjes ka konkluduar se nuk ka rezultuar që subjekti si person nën hetim, në funksionin e prokurorit, të jetë ndikuar në mënyrë të paligjshme, të ketë premtuar apo të ketë kërkuar apo pranuar përfitime të paligjshme në ushtrimin e detyrës si prokuror. Duke u bazuar në nenin 328/1, germa “b” dhe “dh” të Kodit të Procedurës Penale, me aktin e datës 31.05.2017, ai ka vendosur të pushojë hetimet e procedimit penal.

Prokurori i Përgjithshëm, me vendimin nr. {***}, datë 03.07.2017, ka vendosur komandimin e subjektit të rivlerësimit përkohësisht në të njëjtën detyrë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

Më datë 25.09.2017, me vendimin nr. {***}, Prokurori i Përgjithshëm ka vendosur ndërprerjen e komandimit si më sipër dhe kthimin e subjektit të rivlerësimit në pozicionin e mëparshëm, atë të prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Më datë 06.07.2017, është regjistruar kallëzimi penal me nr. {***} prot., kundër subjektit të rivlerësimit etj., për veprën penale *korupsion pasiv*. Në të njëjtën datë, Prokuroria e Përgjithshme ka marrë vendim për *shpallje moskompetence dhe kalimin e akteve të kallëzimit penal nr. 16, të vitit 2017*, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Më datë 10.10.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, regjistroi materialin kallëzues nr. {***}, sipas nenit 319⁶, germa “ç” dhe nenit 248⁷ të Kodit Penal, në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Artur Selmani.

Kallëzimi penal është regjistruar mbi bazën e ankimit të shtetasve I. V. dhe B. R., të cilët kanë pretenduar se prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, Artur Selmani dhe A. M., nuk kanë përkrahur qëndrimin e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit Vlorë në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, me të pandehur A. L. etj., por kanë kërkuar pushimin e akuzave ndaj tyre.

Prokurori i çështjes, me aktin e datës 25.10.2017, ka vendosur të mos fillojë procedimin penal ndaj personit nën hetim, subjektit të rivlerësimit Artur Selmani, me arsyetimin se faktet e kallëzuar nuk përmbajnë elementet e domosdoshme të veprës penale të korrupsionit të funksionarëve të sistemit të drejtësisë dhe, për këtë arsye, fakti penal i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar në nenet 291 e 290/1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale.

42. Subjekti i rivlerësimit, për vlerësimin e aftësive profesionale të tij, ka pretenduar se Komisioni ka shkelur parimin e proporcionalitetit për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, pasi hetimi nuk ka qenë i balancuar. Sipas akteve të administruara në dosje, trupi gjykues konstaton se, në përfundim të seancës dëgjimore në Komision, subjektit të rivlerësimit i është shpjeguar nga relatori i çështjes se vlerësimi profesional i subjektit nuk është bazuar vetëm në një rast, porse vetëm barra e provës i ka kaluar atij për atë rast, i cili është bërë publik, dhe kjo edhe në zbatim të vetë qëllimit

⁶ *Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë.*

⁷ *Shpërdorimi i detyrës.*

të reformës në drejtësi, që është kthimi i besimit të publikut te drejtësia. Gjithashtu, nga relatori i çështjes në Komision, i është shpjeguar subjektit të rivlerësimit se: "[...] ne nuk i heqim absolutisht asnjë presje profesionalizmit tuaj dhe raportit të dërguar nga Prokuroria për të qenë të qartë, por thjesht si rezultat hetimi ne dërgojmë vetëm pjesët ku ne presim shpjegime nga ana juaj dhe kjo ndoshta ka krijuar njëfarë keqkuptimi [...]". Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nga Komisioni është bërë një hetim i plotë dhe i gjithanshëm, duke marrë në shqyrtim si dosjet për vlerësimin profesional të subjektit në zbatim të nenit 43, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, ashtu dhe dosjen nga organi i prokurorisë, në përputhje me nenin 43, pika 4 dhe nenin 44, paragrafi i parë i ligjit nr. 84/2016, si rezultat i informacionit të marrë nga relatori i çështjes nga burime të tjera (media - të shkruara dhe vizuale)⁸. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit.

43. Për pretendimin në ankim të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka interpretuar gabim ligjin, duke e konsideruar pezullimin nga detyra të subjektit si masë disiplinore, ndërkohë që ka qenë pezullim i detyruar, vlerësojmë se Komisioni nuk e ka qartësuar në vendim përfundimin që ka arritur në kuptim të këtij pretendimi të subjektit, i cili është ngritur edhe në përgjigje të rezultateve të hetimit. Në paragrafët 2.30 - 2.32 të vendimit të Komisionit vërejmë se Komisioni nuk ka përcaktuar përfundimisht nëse pezullimi ndaj subjektit të rivlerësimit është dhënë si masë disiplinore në kuptim të nenit 110 të ligjit nr. 96/2016 apo si pezullim mbi bazë diskrecioni në kuptim të nenit 152 të ligjit nr. 96/2016, duke e bazuar konkluzionin e vet në faktin që në secilin prej rasteve, ky fakt shkaktonte dëm në imazhin e prokurorit dhe diskreditonte figurën e tij. Trupi gjykues i Kolegjit në analizë të provave në dosjen e gjykimit, vlerëson se pezullimi i bërë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë një masë disiplinore, pasi referuar vërtetimit të Prokurorisë së Përgjithshme⁹ nr. {***}, datë 07.11.2018, urdhri i pezullimit nga detyra ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është trajtuar nga Prokurori i Përgjithshëm si masë disiplinore, si dhe se ndaj subjektit nuk rezulton të ketë pasur asnjëherë një proces disiplinor apo masë disiplinore gjatë gjithë periudhës së tij të punës.

Nga përmbajtja e aktit të pezullimit, në vlerësimin e trupit gjykues, urdhri nr. {***}, datë 23.02.2017, i Prokurorit të Përgjithshëm përbën pezullim mbi bazë diskrecioni, në kuptim të nenit 152, pika 1, shkronja "a" e ligjit nr. 96/2016, duke qenë se ndaj subjektit të rivlerësimit kishte nisur një hetim penal, dhe duke qenë se në urdhrin e pezullimit parashikohej që ky pezullim do të zgjaste deri në momentin e përfundimit të hetimeve të procedimit penal. Gjithashtu, në analizë të konkluzionit të Komisionit¹⁰ se subjekti duhet të kishte investuar gjykatën për të goditur urdhrin e pezullimit të tij nga detyra, nisur nga sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues vlerëson se duke qenë që ky pezullim i subjektit është pezullim mbi bazë diskrecioni, subjekti me të drejtë argumenton që nuk kishte asnjë arsye ligjore për t'u ankuar ndaj urdhrin të prokurorit.

44. Lidhur me pretendimin se Komisioni ka bërë një vlerësim të gabuar të provave që flasin rreth vërtetësisë së deklarimeve të subjektit për përfaqësimin para Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë,

⁸ Shih pikën 2.1 të vendimit të Komisionit.

⁹ Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

¹⁰ Shih pikën 2.27 të vendimit të Komisionit.

nga analiza e provave të gjendura në dosjen e gjykimit, veç deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, ndihmëses së tij ligjore dhe ish-drejtoreshës A. M., gjendet edhe *e-mail*-i i subjektit të rivlerësimit drejtuar ish-drejtoreshës A. M., ku vërehet qartë që ish-drejtoreshës i është dërguar relacioni i ndihmëses ligjore K. M., relacion ky që është thujse i njëjtë me qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit në Gjykatën e Lartë. Sipas akteve të administruara në dosje, si dhe nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, trupit gjykues të Kolegjit i rezulton se drejtoresha ka qenë e informuar lidhur me qëndrimin që do të mbante subjekti në procesin në Gjykatën e Lartë. Për trupin gjykues të Kolegjit, nëse ajo do të kishte pasur kundërshtime, do të duhej të urdhëronte ndryshimin e qëndrimit që duhet të mbahej prej tij, ose duhet të kishte njoftuar Prokurorin e Përgjithshëm në lidhje me çështjen në fjalë. Trupi gjykues i Kolegjit e çmon të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me qëndrimin jo të saktë që ka mbajtur Komisioni në vendimin përfundimtar për këtë moment¹¹, bazuar në faktin që nuk ka pasur asnjë lloj reagimi nga ish-drejtoresha, madje as kthim përgjigjeje të *e-mail*-it të sipërcituar, dhe në faktin që se nuk gjendet në dosje asnjë provë që të vërtetojë se ajo ka qenë në kundërshtim me qëndrimin që do të mbahej nga subjekti në procesin në Gjykatë të Lartë, përveç shpjegimeve së saj.

45. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka gabuar në zbatimin e ligjit, kur vlerësimin profesional të tij e bazon te qëndrimet dhe opinionin ligjor i shfaqur nga subjekti i rivlerësimit para Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke kapërcyer kështu kompetencat e tij, *së pari* konstatojmë se Komisioni, në lidhje me këtë kriter vlerësimi, nuk i ka mbështetur konkluzionet e veta te pasaktësia, gabimet thelbësore dhe/ose serioze të subjektit të rivlerësimit, siç pretendohet nga subjekti në ankim, por në faktin se referuar dhe urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm, por edhe komenteve në media të ndryshme të shkruara apo audiovizive të kohës, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Nisur edhe nga sa është argumentuar më sipër, trupi gjykues rithekson qëndrimin e tij se këto konkluzione nuk i kanë shërbyer Komisionit në mënyrë direkte për të vendosur në lidhje me shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, porse ato janë përdorur në kuadër të vlerësimit tërësor të procedurave.
46. Në lidhje me çështjen penale në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga prokuroritë e dy shkallëve të para të gjykimit, si dhe nga vendimet penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatës së Apelit Vlorë, të cilat kanë përcaktuar dënime maksimale për të pandehurit A. B. (35 - 1/3 x 35 vite), B. A. (35 - 1/3 x 35 vite) dhe A. Ll. (35 vite). Subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 15.02.2017, ka kërkuar përfundimisht: "Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, për sa i përket të pandehurit A. Ll., duke e deklaruar atë fajtor për veprën penale të vrasjes nga pakujdesia në dëm të shtetasit A. Ll., parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal dhe caktimin e një dënimi prej 4 vjetësh burgim, si dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë për të pandehurit A. B. dhe B. A., vetëm për fajësinë dhe dënimet përkatëse të tyre për kryerjen e veprës penale të armëmbajtjes pa leje, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal". Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos pranuar kërkimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. {***} i vendimit ({***}), datë 23.02.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 01.11.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

¹¹ Shih 2 fjalitë e fundit të pikës 2.17 të vendimit të Komisionit.

47. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 79, datë 14.12.2017, ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit si më sipër të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, ndër të tjera, edhe për shkak të faktit që Gjykata e Lartë nuk ka analizuar në vendim qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit (prokurori Artur Selmani) në atë gjykim.
48. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në faktet që:
- i. çështja penale në fjalë është kthyer për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, ndër të tjera, edhe për shkak të faktit që Gjykata e Lartë nuk ka analizuar në vendim qëndrimin e mbajtur nga subjekti i rivlerësimit Artur Selmani në atë gjykim, duke cenuar kështu parimin e arsytimit të vendimit si parim kushtetues;
 - ii. hetimi penal ndaj subjektit të rivlerësimit është pushuar, ndër të tjera me argumentin që: "Vetëm fakti i qëndrimit krejtësisht të kundërt të prokurorit në seancë gjyqësore me qëndrimet e prokurorit të çështjes në shkallë të parë apo prokurorit të apelit nuk mund në asnjë rast të konsiderohet i tillë që të përmbajë elemente të ndonjë vepre penale";
 - iii. nuk ka pasur asnjë procedim disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit lidhur me çështjen në fjalë¹²;
- vlerëson si jo të drejtë konkluzionin e Komisionit që subjekti i rivlerësimit, referuar urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm, por dhe komenteve në media të ndryshme, të shkruara apo audiovizive të kohës, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi vlerësimi i një subjekti nuk mund të mbështetet në artikuj të ndryshëm të medias dhe jehonës që bëjnë ato në publik, por vetëm në faktet e provuara dhe në ligj.
49. Lidhur me pretendimin në ankim të subjektit të rivlerësimit se në kryerjen e vlerësimit profesional Komisioni ka shkelur rregullat procedurale të parashikuara nga ligji, pasi vlerësimi profesional bëhet vetëm për 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës, ndërkohë që subjekti ka marrë pjesë në lojëra fati në vitet 2006-2008, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht konkluzioneve për këtë kriter në vendimin e Komisionit, ai nuk ka vendosur shkarkimin e subjektit për këtë kriter të rivlerësimit. Megjithatë, në analizë të këtij pretendimi, në vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese, konkretisht në pikën 57 të këtij vendimi, parashikohet: "Gjykata vlerëson se, si rregull, bazuar në pikën 3 të nenit 41 të ligjit, periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale do të jetë 3 vjetët e fundit të ushtrimit të detyrës. Megjithatë, edhe pse ky nen, në pikën 4, ka parashikuar shtrirjen e këtij vlerësimi për një periudhë më të gjatë kohore, e cila potencialisht mund të jetë edhe mbi 10 vjet, kjo dispozitë duhet të zbatohet vetëm në raste përjashtimore dhe në bazë të një vendimi të marrë gjithashtu nga organet e reja kushtetuese të rivlerësimit. Po ashtu, sipas kësaj dispozite, edhe në raste të tilla informacionet merren parasysh nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit. Duke zbatuar edhe në këtë rast interpretimin pajtues të normës, gjykata vlerëson se kjo është mënyra se si duhet të interpretohet pika 4 e nenit 41 të ligjit nr. 84/2016 nën dritën e standardeve kushtetuese dhe se një interpretim i ndryshëm i saj mund të bëhet shkak edhe për trajtimin e pabarabartë të subjekteve të rivlerësimit".

¹² *Shih vërtetimin e Prokurorisë së Përgjithshme.*

Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se hetimi përtej afatit 3-vjeçar ndaj subjektit të rivlerësimit është bërë për shkak të hetimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pra në këtë rast për analizën e të ardhurave të krijuara nga lotaritë sportive për të cilat subjekti nuk kishte paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, ndaj në këtë kuptim vlerësojmë se edhe pse nuk ka një vendimmarrje të Komisionit për të shtrirë hetimin për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, atij nuk i cenohen të drejtat sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të sipërpërmendur.

50. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton gjithashtu se nga Prokuroria e Përgjithshme nuk ka pasur asnjë procedim disiplinor, edhe në kuptim të shkeljes së rregullave të etikës, në emër të subjektit të rivlerësimit përgjatë gjithë karrierës së tij, edhe pse ai ka deklaruar në deklaratat periodike të pasurisë të cilat janë të hapura për publikun, që në vitet 2006-2008, ka marrë pjesë në lotari sportive. Gjithashtu gjatë procesit të rivlerësimit nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të kishte vazhduar përfshirjen e tij në lotari sportive për një periudhë të paktën 10-vjeçare, madje subjekti i rivlerësimit ka shprehur si në përgjigjet ndaj rezultateve të hetimit, si në seancë dëgjimore, në përgjigje të pyetjes së vëzhgueses ndërkombëtare dhe në ankim, një pendesë të dukshme për këto veprime të tij (pjesëmarrje në lotari sportive), që në fakt sipas tij janë ndërprerë përpara shumë viteve, duke deklaruar madje se ai është shkëputur nga kjo veprimtari dhe se ndihet i keqardhur që ka qenë pjesë e saj.
51. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, nga vendimi përfundimtar i Komisionit, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk është shkarkuar nga detyra në bazë të dispozitës së parashikuar për këtë qëllim për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale në ligjin nr. 84/2016, konkretisht nenin 61, pika 4 e këtij ligji. Sipas vendimit, Komisioni e ka mbështetur shkarkimin e subjektit vetëm te kriteri i vlerësimit të pasurisë, parashikuar nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe nga neni 61, pika 5 e po këtij ligji, por duke mos e përfshirë pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit në lojërat e fatit për tri vite, si një nga shkaqet që passolli shkarkimin nga detyra të tij për cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
52. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e gjen jo të drejtë konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit duke marrë pjesë në lojërat e fatit, në vitet 2006-2008, ka cenuar figurën dhe integritetin e tij, duke ulur shkallën e besueshmërisë te publiku.
53. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të drejtë arsyetimin e bërë nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi subjekti i rivlerësimit Artur Selmani ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter rivlerësimi, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk arriti të justifikojë me dokumentacion ligjor të ardhurat nga lotaritë sportive në vlerën 10.000 USD, dhuratat nga personat e tjerë të lidhur, nga motra e subjektit të rivlerësimit, znj. T. S., si dhe nga nëna e tij, znj. D. S. (dhurimet nga të ardhurat e pretenduara se janë përfituar nga pensioni i saj në Itali), si dhe mungesën e burimeve financiare të ligjshme në vlerën totale prej 3,5 milionë, lekësh për periudhën 2003-2016.
54. Trupi gjykues nuk e gjen të drejtë arsyetimin e përdorur nga Komisioni në vlerësimin tërësor të çështjes, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut për shkak se nuk ka kërkuar në gjykatë anulimin e urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm për pezullimin e tij nga detyra,

si dhe për shkak të komenteve në media të ndryshme të kohës, pasi nuk i vlerëson këto rrethana si të tilla që arrijnë të cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

55. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit në mbështetje të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se vendimi nr. 82, datë 26.11.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 82, datë 26.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artur Selmani.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 14.10.2019.

GJYQTAR

Ardian Hajdari

nënshkrimi

GJYQTAR

Luan Daci

nënshkrimi

GJYQTAR

Rezarta Schuetz

nënshkrimi

RELATORE

Natasha Mulaj

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana Shtylla

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Ne, gjyqtaret Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj, paraqesim këtë mendim paralel për një ndër aspektet e ankimit të subjektit të rivlerësimit Artur Selmani, e konkretisht atë që lidhet me vlerësimin nga Komisioni të angazhimit të tij në lojëra fati si sjellje që cenon besimin e publikut, përmbledhur në pikat 3.8 – 3.10 të vendimit të Komisionit dhe c/7 të vlerësimit tërësor (faqet 29, 30 dhe 31 të vendimit). Komisioni ka vënë re që edhe pse nuk ishte ndaluar me ligj, angazhimi në lojëra fati përgjithësisht nënkupton varësi dhe kjo e fundit ka pasoja mbi imazhin në publik. Është e vërtetë që pjesëmarrja në lojëra fati nuk është parashikuar shprehimisht si sjellje e papërshtatshme për një magjistrat, por jemi dakord me këtë vlerësim të Komisionit për arsyet e shtjelluara më poshtë.
2. Ndërsa konstatojmë që vetë subjekti e ka distancuar veten nga këto sjellje të shkuara dhe reflekton maturi gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, me mënyrën se si i sheh ai tanimë veprimet e tij të shkuara, çmojmë se pretendimi i tij në ankim se vendimi i Komisionit bazohet në një vlerësim subjektiv dhe të padrejtë, bie ndesh edhe me shpjegimet e veta, referuar në vendimin e Komisionit në paragrafët 3.6 dhe 3.7, faqe 28 dhe 29. Në shpjegimet e tij, gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit shprehet ndër të tjera se edhe ai vetë, gjatë procesit të rivlerësimit është ndërgjegjësuar për aspektet etike të përfshirjes në lojërat e fatit dhe shprehet: “[...] vura re sesa lehtësisht mund të thyhej e cenohej besimi i publikut ndaj meje si prokuror, madje edhe në kushtet kur më parë ky besim ishte shfaqur si i palëkundshëm [...]”¹³.

Me fjalë të tjera, ndërsa më herët pranon në parim se fenomeni në fjalë ka potencial të reflektojë negativisht mbi perceptimin që ka publiku ndaj prokurorit, në ankimin kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që lidhet me rivlerësimin e atij vetë, subjekti i rivlerësimit parashtron një sërë kundërshtimesh nga ana parimore dhe faktike, në kontrast të theksuar me reflektimet e tij të mëparshme.

Së pari, sjellim në vëmendje që kuadri ligjor që rregullon sjelljen e prokurorëve ka parashikuar vazhdimisht sanksione për sjellje të cilat kanë potencial të cenojnë figurën e prokurorit. Konkretisht, rregullat e sjelljes së prokurorëve deri në hyrjen në fuqi të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përcaktoheshin nga ligji nr. 8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse. Në atë ligj, që ka qenë në fuqi edhe në periudhën kohore gjatë së cilës subjekti ka pranuar angazhimin në lojëra fati [vitet 2006-2008], në nenin 32 që rregullon shkeljet disiplinore parashikohet si një ndër shkeljet e rënda disiplinore edhe “[...] d) kryerja e veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit [...]”. Kodi i Etikës së Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë është miratuar si një dokument i tillë më 19.06.2014¹⁴ dhe ka përcaktuar rregulla të detyrueshme mbi etikën dhe sjelljen për t’u zbatuar nga prokurorët. Po aty janë adresuar në mënyrë të hollësishme edhe rregulla të sjelljes në jetën private, përkatësisht në nenet 3, pika 1, germet “b”,

¹³ Shih faqen 28 të vendimit të Komisionit nr. 82, datë 26.11.2018.

¹⁴ Rregullat mbi sjelljen dhe etikën e prokurorëve:

http://www.pp.gov.al/web/19_06_14_rregulla_te_etikes_dhe_sjelljes_se_prokuroreve_rsh_qershor_2014_2_827.pdf

“e” dhe “ë” dhe 10, pikat 2 dhe 3. Më pas, ky koncept është shtjelluar me ligjin nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”¹⁵ ku në nenin 101, pika 1, germa “a” parashikohet “[...] magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbyshje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë [...]”.

3. Në dritë të sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vetëm gjatë procesit të rivlerësimit është ndërjegjësuar të shohë sjelljen e tij të mëparshme në kuadër të këndvështrimit të publikut, është vështirë të pranohet. Si prokuror me përvojë që ka shërbyer në institucionet më të larta të prokurorisë së Republikës së Shqipërisë, subjektit i binte barrë të analizonte gjithë sjelljet e tij në punë dhe jashtë saj, në funksion të pasojave që kishte sjellja e tij në perceptimin e publikut, dhe të vepronte në përputhje me standardet profesionale që priten nga një funksionar i nivelit dhe profilit të tij të punës. Sipas udhëzimeve evropiane “Mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, miratuar nga Konferenca e 6-të e Prokurorëve të Përgjithshëm të Evropës (Budapest, maj 2005), që ka shërbyer për bazë edhe për “Rregullat e etikës dhe sjelljes së prokurorëve në Shqipëri”, “[...] edhe në sjelljen në jetën private, prokurorët duhet të kujdesen për të ruajtur dhe forcuar besimin e publikut në profesionin e tyre [...]”.¹⁶ Po aty, fitimi i besimit të publikut është lidhur direkt me sjelljen e prokurorëve në të gjitha rrethanat e ndryshme, duke e ndërvarur nga një sjellje shembullore.¹⁷
4. Standardet e sjelljes së gjyqtarëve dhe prokurorëve, për rrjedhojë, janë të njëjta me ndryshimet përkatëse të specifikës së punës së secilit. Ky ka qenë më tej qëndrimi i mbajtur edhe nga Deklarata e Bordosë (Bordeaux Declaration) më 8 dhjetor 2009, sipas së cilës organizatat që përfaqësonin këto dy profesione në kuadrin e Këshillit të Evropës, dhanë opinionet përkatëse. Sipas kësaj deklarate, ndër të tjera, si aktorë kryesorë në administrimin e drejtësisë, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të ruajnë në çdo kohë nderin dhe dinjitetin e profesionit dhe të sillen në të gjitha situatat siç i ka hije funksionit të tyre zyrtar.
5. Burimi më i spikatur i standardeve ndërkombëtare të etikës gjyqësore, Komentari i Bangalores për sjelljen e gjyqtarëve, ndalet veçanërisht tek angazhimi në lojërat e fatit nga magjistratët. Ndërsa hartuesit vënë re që nuk ka ndalim në parim në angazhimin rastësor në këto lojëra si aktivitet dëfrimi, rekomandojnë diskrecion dhe kujdes, duke pasur parasysh gjithmonë perceptimin e një vëzhguesi të arsyeshëm brenda komunitetit, dhe theksojnë:

“[...] ndryshe është një vizitë rastësore në garat e kuajve ose në një kazino jashtë vendit gjatë pushimeve, ose lojëra me letra me shokë dhe familje. Mund të jetë diçka krejt e

¹⁵<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2019/07/18/48/018c1393-272e-417b-b873-7abcbe84806c;q=ligji%20nr.%2048%2F2019>

¹⁶ Shih seksionin IV, germa “c” e <https://rm.coe.int/conference-of-prosecutors-general-of-europe-6th-session-organised-by-t/16807204b5>.

¹⁷Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm të Evropës, sesioni VI, Udhëzime evropiane mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve – Udhëzimet e Budapestit, CPGE(2005)05, 31 maj 2005, Pika II.

ndryshme që një gjyqtar të qëndrojë rregullisht në dritaret e basteve ose korsitë e garave apo të bëhet një bixhozxi i përhershëm ose klient i rregullt [...]”¹⁸

6. Sipas të njëjtit burim (komenti 114), një gjyqtar – dhe për paralel, një magjistrat – duhet të pranojë kufizime në jetën e vet, kufizime të cilat një qytetari të thjeshtë mund t’i duken barrë e rëndë të cilën duhet ta pranojë lirisht dhe me vullnet, edhe nëse këto aktivitete janë larg syve të publikut.
7. Në përmbyllje, në vlerësimin tonë, frekuentimi i ambienteve të lojërave të fatit nga subjekti i rivlerësimit, është sjellje që ndikon negativisht në perceptimin e publikut për figurën e një magjistrati. Në këtë vlerësim, duke pasur parasysh edhe konceptin e shtjelluar nga Komentari i Bangalores që “[...] ligjshmëria e sjelljes, megjithëse ka peshë, nuk përbën gjithçka në vlerësimin e përshtatshmërisë së sjelljes [...]” dhe faktin që lojërat e fatit janë një aktivitet me peshë financiare të konsiderueshme, vlerësojmë se frekuentimi disavjeçar i këtyre ambienteve nga ana e subjektit, si një funksionar publik me të ardhurat që sjell ky pozicion, përbën një sjellje që në këndvështrimin e një vëzhguesi të arsyeshëm ndikon negativisht në perceptimin e gjithë profesionit. Për këtë arsye, çmojmë se ka qenë i drejtë konkluzioni i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për këtë aspekt të rivlerësimit të subjektit Artur Selmani.

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

¹⁸ Shih komentin nr. 117: Lojërat e fatit në:
https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/commentary_on_the_bangalore_principles_of_judicial_conduct/bangalore_principles_english.pdf.